

**UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”**  
**Njoftim për vend të lirë pune**

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nën 57 “Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”, e nën 66 “Personeli ndihmës akademik” si dhe Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej” shpall konkursin për 1 (një) pozicione pune, në angazhim me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar si “Specialiste për projekte”. Po ju dërgojmë bashkëngjitur në format elektronik dhe të shkruar, njoftimin dhe kriteret përkatëse;

1. Të zotërojnë formimin universitar “Bachelor” dhe “Master” ose sistemin 4-vjeçar në gjuhën angleze, me notë mesatare mbi 8 (tetë);
2. Të ketë të paktën 10 vite eksperiencë pune në profesion.
3. Të ketë ushtruar përdorimin e gjuhës angleze në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare në vazhdimësi;
4. Të ketë trainime dhe certifikime me objekt fushën e menaxhimit akademik dhe të projekteve;
5. Preferohen së pari kandidatët që kanë eksperiencë në fushën e menaxhimit të projekteve universitare ose eksperiencë të ngjashme;
6. Të jetë i/e përkushtuar dhe i/e aftë të përballojë ngarkesën në punë;
7. Të zotërojë me dëshmi, metodat e reja të informacionit dhe të ketë aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit në programet bazë operative të tij;
8. Të zotërojë me dëshmi që tregojnë se ka aftësi kërkimore, aftësi në menaxhim etj.
9. Të ketë aftësi të mira analitike, aftësi shumë të mira komunikimi dhe shprehëse;
10. Të ketë aftësi shumë të mira organizative, si dhe për të punuar në grup, angazhim profesional, efikasitet në punë, etj.
11. Të jetë i/e gatshëm/e të udhëtojë dhe të punojë me orë të zgjatura nëse do jetë e nevojshme, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe projektit në zbatim;
12. Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara.
13. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

**Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë:**

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës dhe të listës së notave përkatëse (të noteruara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë të notuar);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);

7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrimin tuaj;
10. Dëshmi penaliteti

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumentave, sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UGJ-së. Dokumentat e mësipërm të noterizuar, të 3 (tre) muajve të fundit dhe dorëzohen pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndhmës Akademike-Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej" të shoqëruara me inventar.

**Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 5 ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.**